



RAPORTI I REZULTATEVE

**Aktivitet Rajonal për Evropën Juglindore:
Monitorimi i burgjeve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut
ndërsa parandalojmë dhe luftojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe
radikalizimin që çojnë në terrorizëm (EDHRÇT) në burgje**

Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë – 13-14 shtator 2023

nëntor 2024

**Aktivitet Rajonal për Evropën Juglindore:
Monitorimi i burgjeve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut
ndërsa parandalojmë dhe luftojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe
radikalizimin që çojnë në terrorizëm (EDHRÇT) në burgje**

Përmbajtja e lëndës

I.	HYRJE.....	1
II.	PËRMBLEDHJE E AKTIVITETIT	2
	Sesioni 1: Përcaktimi i kontekstit – pse është i rëndësishëm monitorimi i pavarur i burgjeve për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje?.....	3
	Sesioni 2: Praktika dhe qasje – Parandalimi dhe luftimi i EDHRÇT-së në burgje.....	4
	Sesioni 3: Sfidat kryesore të të drejtave të njeriut lidhur me parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje në Evropën Juglindore	7
	Sesioni 4: Mandatet, praktikat dhe qasjet ndaj monitorimit në burgje.....	9
	Sesioni 5: Sfida dhe praktika të mira lidhur me monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore.....	11
	Sesioni 6: Rekomandime për forcimin e monitorimit të pavarur të burgjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore.....	13
III.	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME KRYESORE.....	13
	SHTOJCË: AGJENDA.....	17

I. HYRJE

Më 13-14 shtator 2023, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë (OMBiH), organizoi një aktivitet rajonal në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, të titulluar “*Monitorimi i burgjeve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet ekstremizmi e dhunshëm dhe radikalizimi që çon në terrorizëm (EDHRÇT) në burgje: aktivitet rajonal për Evropën Juglindore*”. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues të autoriteteve përkatëse, strukturave kombëtare të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile nga juridiksionet në Evropën Juglindore me zyra aktive të OSBE-së në terren, si dhe ekspertë dhe partnerë të OSBE-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Ata u përfshinë në dialog dhe diskutuan çështje të shumta të të drejtave të njeriut që lindin gjatë parandalimit dhe luftimit të EDHRÇT-së në kontekstin e burgjeve dhe se si këto çështje mund të trajtohen në praktikë.

Në këtë kuadër, aktiviteti rajonal nënvizoi rëndësinë thelbësore të monitorimit të pavarur të situatës gjatë ndalimit në burgje dhe rritjes së mbikëqyrjes si një mjet për të siguruar mbrojtje më të madhe të të drejtave të personave të privuar nga liria, duke parandaluar dhe luftuar në mënyrë efektive EDHRÇT-në në burgje. ODIHR-i gjithashtu prezantoi në këtë aktivitet përkthimet në gjuhën shqipe dhe boshnjake të botimit të ODIHR-it dhe të Reformës Penale Ndërkombëtare (RPN), *Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Burgje ndërsa parandalohet radikalizimi që çon në terrorizëm ose dhunë: Udhëzues për monitoruesit e burgjeve (më poshtë: Udhëzuesi i ODIHR-it/RPN-së për Monitoruesit e Burgjeve)*¹. Udhëzuesi dokumenton se si rreziqet e radikalizimit që çojnë në terrorizëm mund të zvogëlohen nga një mbrojtje më e fortë e të drejtave të njeriut në burgje. Ai shqyrton në detaje disa fusha konkrete rreziku ndaj të drejtave të njeriut në lidhje me masat që shtetet, ose më konkretisht autoritetet e burgjeve, po marrin për të menaxhuar të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar)² dhe për të parandaluar përhapjen e EDHRÇT-së në burgje. Gjithashtu, ai përmban udhëzime dhe mbështetje për monitoruesit e pavarur të burgjeve për vlerësimin e ndikimeve të masave të tilla mbi të drejtat e njeriut.

Si rezultat praktik, aktiviteti rajonal u përpoq të identifikonte në nivel kombëtar dhe rajonal sfidat e ndryshme që ekzistojnë në lidhje me këto fusha të larmishme diskutimi, dhe të formulonte rekomandime kryesore me qëllim promovimin e strategjive dhe qasjeve të bazuara në të drejtat e njeriut që trajtojnë çështjen e EDHRÇT-së në burgje. Ky raport i rezultateve përmban informacion të shkurtër rreth aktivitetit rajonal, një përmbledhje të pikave kryesore të diskutimit në çdo sesion, si dhe një përmbledhje të rekomandimeve kryesore, të cilat kanë buruar nga aktiviteti.

¹ Publikimi është i disponueshëm në gjuhën shqipe, boshnjake, angleze, frënge dhe ruse: ODIHR, *Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Burgje ndërsa parandalohet radikalizimi që çon në terrorizëm ose dhunë: Udhëzues për monitoruesit e burgjeve*, 15 korrik 2021 <https://www.osce.org/odih/492934>.

² Termi të burgosur ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) sipas Udhëzuesit të ODIHR-it/RPN-së kuptohet jo si grup homogjen, por mund të përfshijë persona të dyshuar ose të dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin, si dhe ata që perceptohen, pavarësisht veprave për të cilat janë dënuar, si të lidhur me grupe terroriste ose të dhunshme ekstremiste në burgje, ose konsiderohen si “në rrezik” ose me gjasa për t'u përfshirë në VERLT. Shih Udhëzuesin e ODIHR/RPN-së për monitoruesit e burgjeve, f. 11.

Historiku

ODIHR-i e organizoi aktivitetin rajonal në kuadër të punës së tij të vazhdueshme për të drejtat e njeriut dhe antiterrorizmin si dhe parandalimin e torturës dhe të një projekti shumëvjeçar për forcimin e mbrojtjes së personave të privuar nga liria në rajonin e OSBE-së. Si pjesë e projektit, Zyra organizoi dy aktivitete rajonale në pjesë të ndryshme të zonës së OSBE-së për të promovuar dialogun ndërmjet politikëbërësve, profesionistëve dhe monitoruesve të burgjeve me synimin për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e monitorimit të pavarur të burgjeve në kontekstin e parandalimit dhe luftimit të EDHRÇT-së në burgje.³ Duke u mbështetur në këto aktivitete, ODIHR-i zhvilloi një trajnim praktik për monitoruesit e pavarur të burgjeve, bazuar në *Udhëzuesin e ODIHR-it/RNP-së për monitoruesit e burgjeve*, për të rritur kapacitetin e tyre për të analizuar dhe vlerësuar sistematikisht çështjet e ndryshme të të drejtave të njeriut që mund të lindin gjatë parandalimit dhe luftimit të radikalizimit që çojnë në dhunë në burgje. Deri tani, ODIHR-i e ka ofruar trajnimin në tre kurse të dedikuara për monitoruesit e burgjeve nga vende të përzgjedhura në Azinë Qendrore, Evropën Juglindore dhe Bashkimin Evropian dhe shtete të tjera.⁴ Në të ardhmen parashikohet të organizohen kurse të mëtejshme trajnimi në shtetet e tjera pjesëmarrëse të OSBE-së.

II. PËRMBLEDHJE E AKTIVITETIT

Aktiviteti rajonal në Sarajevë mblodhi së bashku rreth 71 pjesëmarrës nga juridiksione të Evropës Juglindore ku OSBE-ja ka zyra në terren,⁵ duke përfshirë profesionistë të fushave të ndryshme, që përfshinë si autoritetet ashtu edhe aktorët e shoqërisë civile në nivel kombëtar. Pjesëmarrësit përfshinë përfaqësues nga autoritetet përkatëse kombëtare (duke përfshirë ministrinë e brendshme, të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe shërbimet e burgjeve), mekanizma të ndryshëm të të drejtave të njeriut dhe mbikëqyrjes së burgjeve, të tilla si Zyrat e Avokatit të Popullit/Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) dhe Mekanizmat Parandalues Kombëtarë (MPK) të krijuara në bazë të Protokollit Fakultativ të Konventës së OKB-së kundër Torturës (OPCAT), si dhe monitoruesit e shoqërisë civile. Duke pasur parasysh rëndësinë globale të temës, përfaqësues të ndryshëm ndërkombëtarë dhe ekspertë të tjerë kontribuan gjithashtu gjatë aktivitetit. Ata përfshinin përfaqësues të RNP-së, Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Nënkomitetin e OKB-së për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, Këshillin e Evropës, duke përfshirë Komitetin Evropian për Parandalimin e Torturës

³ Përveç këtij aktiviteti, shihni gjithashtu <https://www.osce.org/odihr/547939>. ODIHR-i, së bashku me RPN-në, gjithashtu organizuan një uebinar për botimin e përkthimit në frëngjisht të Udhëzuesit për monitoruesit e burgjeve për shtetet pjesëmarrëse frankofone, partnerët e OSBE-së për Bashkëpunim dhe më gjërë, shihni <https://www.osce.org/odihr/569775>.

⁴ Shihni <https://www.osce.org/odihr/556932>, <https://www.osce.org/odihr/563139> dhe <https://www.osce.org/odihr/570930>.

⁵ Nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, si dhe Kosova (nuk ka konsensus midis shteteve anëtare të OSBE-së për statusin e Kosovës dhe, për rrjedhojë, Organizata nuk ka qëndrim për këtë çështje. Të gjitha referencat për Kosovën, qoftë për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhen kuptuar në përputhje të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara).

dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (KPT), Bashkimin Evropian (BE) si dhe zyrat e OSBE-së në terren, Sekretariatit e OSBE-së dhe të ODIHR-it.⁶

Për të mundësuar një diskutim ndëraktiv dhe dinamik, aktiviteti u konceptualizua në gjashtë sesione të veçanta, në seanca plenare dhe në grupe pune. Seancat plenare përfshinin prezantime të shkurtra nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë, segmente me pyetje dhe përgjigje dhe debat të hapur, ndërsa seancat e grupeve të punës e ndanë audiencën e gjerë në grupe më të vogla bashkëpunuese. Fokusi i përcaktuar gjeografik i aktiviteteve mundësoi një shkëmbim të gjallë informacioni dhe përvojash nga rajoni i Evropës Juglindore, ku u dhanë kontribute edhe nga ekspertë ndërkombëtarë dhe pjesëmarrës të tjerë. Një përmbledhje e agjendës së aktivitetit mund të gjendet në shtojcën e këtij raporti të rezultateve. Aktiviteti u zhvillua sipas rregullit të Chatham House,⁷ i cili është respektuar njësoj edhe gjatë hartimit të këtij raporti.

Sesioni 1: Përcaktimi i kontekstit – pse është i rëndësishëm monitorimi i pavarur i burgjeve për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje?

Sesioni i parë i aktivitetit përfshiu një prezantim të *Udhëzuesit të ODIHR-it/RNP-së për monitoruesit e burgjeve* për t'u prezantuar pjesëmarrësve këtë botim dhe për të krijuar bazën për aktivitetin. Pasi u prezantua struktura me dy pjesë e Udhëzuesit, u theksua rëndësia e monitorimit të pavarur të burgjeve dhe çështje kryesore të të drejtave të njeriut që lidhen me EDHRÇT-në në burgje. Gjithashtu, në këtë sesion u trajtuan katër “fushat e rrezikut ndaj të drejtave të njeriut” të Udhëzuesit në këtë kontekst, duke përfshirë (1) klasifikimin, vlerësimin e rrezikut dhe të nevojave të të burgosurve; (2) regjimin e burgut; (3) programet e rehabilitimit dhe riintegrit; dhe (4) çështjet institucionale dhe të personelit.

Në diskutimin pasues u pranua se mbrojtja e të drejtave të njeriut, brenda dhe jashtë burgjeve, dukej se shpesh lidhej me aspekte të sigurisë, veçanërisht në lidhje me luftën kundër terrorizmit. Ndryshimi terminologjik nga terrorizmi në ekstremizmin e dhunshëm, dhe pakapshmëria e konceptit të EDHRÇT-së, ka ndikuar gjithashtu te të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria.⁸ Për rrjedhojë, të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) ishin më shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të shkeljeve të të drejtave të njeriut. Disa pjesëmarrës theksuan gjithashtu se mungesa e respektimit të të drejtave të njeriut të të burgosurve do të krijonte kushte të favorshme për EDHRÇT-në. Kushtet e tjera të ndërlidhura ose të lidhura ngushtë që kontribuojnë për EDHRÇT-në në mjedisin e burgut përfshinin korrupsionin në burgje; mungesën e sigurisë në burgje; torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese; kushtet e këqija të burgjeve dhe mbipopullimin; dhe ankesat për përdorim joproporcional, diskriminues ose arbitrar të kufizimeve dhe masave të tjera të sigurisë në burg.

⁶ Përfaqësuesit e KiE-s dhe UNODC-së kontribuan në aktivitet online.

⁷ Kur një takim, ose një pjesë e tij, mbahet sipas rregullës së Chatham House, pjesëmarrësit janë të lirë të përdorin informacionin e marrë, por nuk mund të zbulojnë as identitetin, as përkatësinë e folësit ose të ndonjë pjesëmarrësi tjetër.

⁸ Për sfidat konceptuale që lidhen me mungesën e përkufizimeve të pranuar botërisht të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe ndryshimin midis “ekstremizmit” si koncept ligjor në kontekstin e legjisllacionit penal dhe EDHRÇT-së si koncept politikash, shih *Udhëzuesin e ODIHR-it/RNP-së për monitoruesit e burgjeve*, f. 16-17.

Gjithashtu, disa pjesëmarrës vunë në dukje se mbrojtja e të drejtave të njeriut për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje duhet të trajtohet në mënyrë gjithëpërfshirëse në kontekstin më të gjerë të sistemit të drejtësisë penale, duke përfshirë kohën para ndalimit ose dënimit, gjatë burgimit dhe pas lirit. Në veçanti, u theksua rëndësia dhe domosdoshmëria e qasjeve në përputhje me të drejtat e njeriut lidhur me rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar).

Në këtë diskutim, u nënvizua roli thelbësor i monitoruesve të burgjeve, duke përfshirë IKDNJ-të, MKPT-të dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC), në lidhje me mbikëqyrjen kuptimplotë të masave dhe programeve për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe EDHRÇT-së në burgje. Analiza e jashtme e punës së monitoruesve të burgjeve mund të sigurojë që masat për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe EDHRÇT-së të mos të cenojnë të drejtat e të ndaluarve dhe të burgosurve. Gjithashtu, u theksua se monitoruesit e burgjeve kanë rëndësi të madhe kur bëhet fjalë për informimin e publikut të gjerë për masa të tilla në burgje dhe për ndikimin e këtyre masave mbi të drejtat e të burgosurve. Ajo çfarë është me rëndësi, dialogu midis monitoruesve të burgjeve dhe autoriteteve mund të mbështesë hartimin e masave në përputhje me të drejtat e njeriut që mund të forcojë të drejtat e të burgosurve dhe të ndihmojë për trajtimin më efektiv të rrezikut të radikalizimit që çon në terrorizëm dhe rekrutimit në grupe të dhunshme ekstremiste në burgje. Këto pika kyçe u përsëritën gjatë aktivitetit dyditor.

Sesioni 2: Praktika dhe qasje – Parandalimi dhe luftimi i EDHRÇT-së në burgje

Gjatë sesionit të dytë, ekspertë të ndryshëm ndanë përvojat e tyre profesionale të përdorura në rajon në lidhje me praktikën dhe qasjet për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje. Sesioni u hap me tre folës ndërkombëtarë, të cilët u pasuan nga katër prezantues nga Evropa Juglindore. Nga ky diskutim dolën disa tema kryesore, të cilat janë grupuar sipas tematikës.

Në përgjithësi, u vu re se të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) nuk duket se përbënin një pjesë të madhe të popullsisë së përgjithshme të burgjeve në Evropën Juglindore. Në të njëjtën kohë, u pranua se popullsia e burgjeve në rajon ishte shumë e larmishme, përfshirë edhe në lidhje me natyrën e dënimeve të të burgosurve, gjë që nënvizoi rëndësinë e vlerësimit të rrezikut dhe nevojave të individualizuara për klasifikimin dhe shpërndarjen e duhur të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) në regjime të caktuara sigurie dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore.

Menaxhimi i mirë i burgjeve u identifikua si thelbësor për të luftuar radikalizimin që çon në terrorizëm në burgje, duke përfshirë zvogëlimin e mbipopullimit, trajtimin e korrupsionit, sigurimin e niveleve të përshtatshme të personelit dhe trajnimin e rregullt, si dhe përmirësimin e kushteve të punës së personelit të burgjeve, siç përcaktohet edhe nga *Udhëzuesi i ODIHR-it/RNP-së për monitoruesit e burgjeve*. Gjithashtu, pjesëmarrësit theksuan se autoritetet e burgjeve duhet të trajtojnë ankesa dhe pakënaqësi të tjera të mundshme në burg, të cilat mund të radikalizohen më tej dhe të çojnë në terrorizëm. Ata vunë në dukje gjithashtu se një qasje me shumë palë për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje ka rezultuar të jetë më efektive. Për rrjedhojë, aktivitetet duhet të përfshijnë aktorë të ndryshëm qeveritarë, joqeveritare dhe ndërkombëtare sipas nevojës.

Klasifikimi i duhur dhe vlerësimi i rrezikut dhe nevojave të të burgosurve u konsiderua i domosdoshëm gjatë këtyre diskutimeve për të shmangur regjimet e panevojshme ose tepër kufizuese të sigurisë. Për më tepër, klasifikimi i duhur i individëve mund të mbështesë ndarjen dhe vendosjen më efikase në burg, p.sh., në drejtim të menaxhimit të burgjeve, për të siguruar që të burgosurit të kenë qasje te masat e deradikalizimit dhe shkëputjes dhe në drejtim të përmbushjes së nevojave të tyre specifike, të tilla si ato sociale, ligjore, nevojat shëndetësore, rehabilituese dhe riintegruese. Vlerësimet gjithëpërfshirëse dhe individuale të rrezikut dhe nevojave u konsideruan thelbësore veçanërisht për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar). Sipas pjesëmarrësve nga rajoni, shërbimet e burgjeve në disa shtete kanë zhvilluar mjete vlerësimi dhe kanë organizuar trajnime për personelin mbi përdorimin e tyre, shpesh me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. Pavarësisht këtyre zhvillimeve, pjesëmarrësit theksuan se nevojitej një kontroll më efektiv dhe i individualizuar i të burgosurve për të identifikuar personat që janë të cenueshëm ndaj EDHRÇT-së ose që mund të radikalizojnë aktivisht të tjerët për terrorizëm.

Sipas diskutimit, rehabilitimi dhe riintegrimi i të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) mbetet një sfidë në shumicën e shteteve të rajonit. Programet ekzistuese të veprimtarive përfshinin punën, trajnimin, edukimin, veprimtaritë sportive dhe të kohës së lirë, megjithëse shtrirja dhe disponueshmëria e tyre ndryshonte ndjeshëm nga një shtet në tjetrin. Në disa raste, programet për popullsinë e burgjeve në përgjithësi ose për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm në veçanti mungonin plotësisht ose kufizoheshin vetëm në ndërhyrje bazë. U vu në dukje se duhej të kishte një vëmendje më të madhe në programet gjithëpërfshirëse afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata të rehabilitimit dhe riintegrit. Ato duhet të përfshijnë përgatitjen e hershme për lirim, mbështetjen e menjëhershme më pas, si dhe ndjekjen afatgjatë, duke përfshirë të burgosurit ekstremistë të dhunshëm dhe të ashtuquajturit “luftëtarë të huaj terroristë” (LHT). Pjesëmarrësit deklaruan se vlerësimet e duhura të rrezikut dhe nevojave duhet të përbëjnë bazën nëse dhe çfarë lloj programesh rehabilitimi dhe riintegrimi duhet t'u ofrohen të burgosurve në kontekstin e EDHRÇT-së. U theksua gjithashtu nevoja për pjesëmarrje vullnetare në ndërhyrje të tilla dhe në një qasje gjithëpërfshirëse dhe multidisiplinare për zbatimin e tyre, duke përfshirë një gamë të gjerë disiplinash dhe profesionistësh.

Në kuadër të rehabilitimit dhe riintegrit, u vu re se ndërhyrjet e synuara për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) luajtën një rol thelbësor dhe në përgjithësi mund të ndaheshin në programe deradikalizimi ose shkëputjeje.⁹ Gjatë seancës u diskutuan karakteristikat përkatëse të ndërhyrjeve të shkëputjes dhe deradikalizimit në burg dhe nëse njëra qasje ishte më e preferueshme se tjetra. Disa pjesëmarrës shprehën shqetësimin se ndërhyrjet për deradikalizim që synojnë të ndryshojnë besimet specifike fetare të të burgosurve mund të cenojnë të drejtat e njeriut të mbrojtura ndërkombëtarisht për lirinë e fesë ose besimit, si dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes.¹⁰ Nga ana tjetër, programet e shkëputjes u konsideruan si përpjekje për të parandaluar

⁹ Termit nuk përdoren gjithmonë në mënyrë konsistente në praktikë dhe ka një debat të vazhdueshëm nëse ndërhyrjet duhet të përqendrohen te njëra ose tjetra qasje, ose në vend të kësaj të përfshijnë elementë të të dyjave, gjë që ngre çështje të thella të të drejtave të njeriut. Për më shumë informacion dhe një përshkrim të shkurtër të koncepteve, shihni, për shembull, *Udhëzuesin e ODIHR-it/RPN-së për monitoruesit e burgjeve*, f. 84-87.

¹⁰ Programet e deradikalizimit zakonisht hasen me interpretime, pozicione ose argumente specifike (të bazuara në ideologji politike, fetare ose të tjera) që shërbejnë si bazë për besimet dhe qëndrimet e përdorura për të justifikuar

ose ndryshuar marrëdhënien e një personi me një grup, kauzë ose ideologji të caktuar që e sheh dhunën si të justifikuar për të arritur qëllimet e saj, në vend që të ndryshojë bindjet e dikujt. Kjo çështje u rishfaq në disa raste gjatë aktivitetit.

Për më tepër, u nënvizua rëndësia e përgjigjeve ndaj EDHRÇT-së dhe alternativave të dënimit me burgim për të shmangur në radhë të parë burgimin, aty ku ishte e mundur. Pjesëmarrësit vunë re gjithashtu se shërbimet e lirimimit të parakohshëm ose të kushtëzuar dhe të provës kishin një rol të rëndësishëm për të luajtur për të mbështetur rehabilitimin dhe riintegrimin. Megjithatë, instrumente të tilla në përgjithësi dukej se ishin të pazhvilluara dhe të pashfrytëzuara në rajon.

Disa juridiksione kanë zhvilluar programe trajnimi për personelin e burgjeve dhe të provës lidhur me EDHRÇT-në duke mbuluar një larmi temash, duke përfshirë trajnimin mbi treguesit që kanë të bëjnë me të ashtuquajturat “shenjat e hershme të radikalizimit”¹¹ dhe faktorët “shtytës” dhe “tërheqës” të EDHRÇT-së, si dhe parandalimin e përgjithshëm të fenomenit në burgje. Janë zhvilluar gjithashtu programe trajnimi për personelin e burgjeve dhe të provës në lidhje me rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve, ndonëse ato nuk janë ende të mjaftueshme dhe nuk zhvillohen në mënyrë sistematike. U theksua se në rajon nevojiteshin investime më të mëdha sa i takon trajnimit të personelit, përfshirë në lidhje me implikimet e të drejtave të njeriut gjatë parandalimit dhe luftimit të EDHRÇT-së dhe përdorimin e vlerësimeve të rrezikut dhe nevojave.

Në lidhje me LHT-të, pjesëmarrësit raportuan se ose janë zbatuar ose janë në proces zbatimi disa programe në rajon, për të lehtësuar kthimin e tyre dhe të familjarëve të tyre. Ato përbëhen nga komponentë të ndryshëm duke përfshirë përgatitjen për kthimin e tyre, ndjekjen penale dhe dënimin e LHT-ve në raste të caktuara, si dhe riintegrimin e anëtarëve të lidhur të familjes në shoqëri. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për t'u ofruar të dënuarve LHT aktivitete domethënëse në burg për të promovuar rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Ata theksuan më tej se programet në nivel kombëtar duhet të kujdesen për të shmangur stigmatizimin shoqëror të LHT-ve të kthyer dhe anëtarëve të familjeve të tyre.

Gjatë sesionit të dytë u diskutuan çështje të tjera të ndryshme. Disa folës nënvizuan pikën kryesore që reagimet e shteteve ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit duhet të jenë gjithmonë në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ata theksuan se legjislacioni kombëtar kundër terrorizmit nuk duhet të jetë tepër i gjerë dhe masat për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së nuk duhet të cenojnë të drejtat e mbrojtura ndërkombëtarisht të lirisë së fesë ose besimit, si dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes dhe të drejta të tjera. Përveç kësaj, pjesëmarrësit raportuan se në të gjithë rajonin janë hartuar dhe miratuar strategji kombëtare dhe plane veprimi për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit si dhe janë krijuar organet përkatëse koordinuese. Të pranishmit shprehën shqetësimin se shumica e këtyre dokumenteve dhe

përdorimin e dhunës ekstremiste. Nëse masa të tilla i detyrojnë RPN-të të ndryshojnë besimet ose fenë e tyre, ato janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut, f. 84-87.

¹¹ Në të gjithë zonën e OSBE-së, duket se ka një mbështetje në rritje lidhur me shenjat ose treguesit e hershëm të VERLT-së si bazë për vlerësimet e rrezikut dhe nevojave. Autoritetet duhet të paralajmërohen kundër përdorimit të modeleve të thjeshtuara dhe të jenë të vetëdijshme për ndikimin e tyre të mundshëm mbi të drejtat e njeriut. Një i burgosur që plotëson një ose më shumë tregues mund të jetë një shenjë se ai është i radikalizuar në një farë mase ndaj dhunës, por kjo nuk do të thotë se ai do të përfshihet në ekstremizëm të dhunshëm. Shih për shembull, Udhëzuesin e ODIHR/RPN-së për monitoruesit e burgjeve, f. 41.

mekanizmave ishin të përqendruar te ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi i kryer në emër të fesë (p.sh. Islamit), dhe jo te manifestime të tjera të fenomenit (siç është ekstremizmi i ekstremit të djathtë).

Sesioni 3: Sfidat kryesore të të drejtave të njeriut lidhur me parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje në Evropën Juglindore

Sesioni i tretë i aktivitetit ishte një nga dy sesionet kryesore të punës ndëraktive. Ai synonte të identifikonte sfidat kryesore të të drejtave të njeriut lidhur me parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje në Evropën Juglindore. Pas një përmbledhjeje të temës nga një folës që bëri prezantimin e temës, pjesëmarrësit u ndanë në grupe pune. Secili grup u përqendrua te sfidat e përzgjedhura dhe praktikatat e mira në shtetet përkatëse, ose në rajon.

Identifikimi i të burgosurve “të cenueshëm” ndaj EDHRÇT-së – klasifikimi, vlerësimi i rreziqeve dhe nevojave

Diskutimet në grupet e punës vunë në pah se janë ndërmarrë disa nisma në rajon, shpesh me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, për të kontrolluar grupet e të burgosurve të cenueshëm duke përfshirë të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) pas pranimit të tyre në burg, me qëllim klasifikimin e tyre në përputhje me rreziqet dhe nevojat e tyre. Këto projekte kanë synuar të zhvillojnë instrumente specifike të analizimit dhe vlerësimit të rrezikut dhe nevojave dhe të trajtojnë personelin e burgjeve dhe të drejtësisë penale për parandalimin e EDHRÇT-së. Pjesëmarrësit identifikuan shkallë të ndryshme zhvillimi, ku u soll shembulli i një shteti që po piloton një mjet për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, ndërsa një juridiksion tjetër ka zhvilluar një mjet për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, i cili nuk është testuar ende në praktikë. Në juridiksione të tjera, autoritetet e burgjeve përdorin tregues të ndryshëm, shpesh në formën e një pyetëso, për të përcaktuar rrezikun dhe nevojat e përgjithshme të të burgosurve.

Disa faktorë përcaktues të mjeteve të tilla u konsideruan si problematikë, pasi përfshinin jo vetëm shkeljen e kryer dhe ndryshime të perceptuara në stilin e jetës ose sjellje, por edhe qasjen e të burgosurve ndaj fesë, e cila u tha se mund të ndërhynte në të drejtën e tyre për lirinë e fesë ose besimit. Për më tepër, disa pjesëmarrës vunë në dukje se vlerësimi të rrezikut dhe nevojave i mungonin treguesit e përshtatshëm të lidhur me gjininë dhe moshën dhe theksuan se një vlerësim i tillë duhet të kryhet në baza individuale. Gjithashtu, u ngritën shqetësime nga pjesëmarrësit se të burgosurit nuk kishin qasje rutinë në dosjet e tyre të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave dhe nuk dinin të kundërshtonin vendimet. Një problem tjetër ishte mungesa e departamenteve të specializuara të burgjeve dhe e personelit të kualifikuar të burgjeve për të kryer vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, si dhe mungesat e trajnimit për specializimin e personelit.

Regjimet konkrete të burgjeve dhe të sigurisë për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar)

Diskutimet në grupet e punës nxorën në pah se kishte praktika të ndryshme penale në shtetet dhe juridiksionet në Evropën Juglindore në lidhje me ndarjen dhe integrimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) nga dhe në popullsinë e gjerë të burgjeve. Në disa shtete, të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) nuk ishin të ndarë në mënyrë specifike, por ishin

të përzier me popullsinë e përgjithshme të burgjeve. Aty ku përdorej ndarja, të burgosurit përqendroheshin në një ose më shumë institucione penale. Në raste të caktuara, të burgosurit thuhet se iu janë nënshtruar masave të gjera të sigurisë, duke përfshirë mbikëqyrjen audiovizive 24 orëshe dhe kufizime të rrepta, dhe monitorimin e plotë të kontakteve të tyre me botën e jashtme, duke ngritur shqetësime midis pjesëmarrësve. Megjithatë, nuk u raportuan kufizime specifike lidhur me mundësinë e të burgosurve për të komunikuar me avokatët e tyre, ose me MKP-të, ose me organet ndërkombëtare të monitorimit të burgjeve.

Për më tepër, pjesëmarrësit diskutuan rëndësinë e të siguruarit që të burgosurit në mjedise të sigurisë së lartë të kishin mundësi për të kaluar drejt regjimeve më pak kufizuese, sikurse kërkohet nga praktikat më të mira penale. Ndërkohë që disa pjesëmarrës përshkruan disa raste të të burgosurve të dhunshëm ekstremistë ku ka pasur përparim hap pas hapi drejt mjediseve më pak kufizuese të burgjeve, ekzistonte shqetësimi se në disa shtete të rajonit kjo mundësi dukej se ekzistonte vetëm në letër.

Disponueshmëria e masave rehabilituese dhe riinteguese për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar)

Diskutimet në grup zbuluan ngjashmëri dhe dallime në lidhje me masat e rehabilitimit dhe riintegritimit në rajon. Në disa shtete, programet e synuara për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm nuk ekzistonin, ose ishin zhvilluar vetëm pjesërisht. Në këto raste, OSHC-të ishin aktorët kryesorë për zbatimin e programeve të tilla. Në kontekste të tjera, ishin zhvilluar programe me mbështetjen e një organizate ndërkombëtare, e cila përfshinte politika specifike para dhe pas lirimit të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm. Në juridiksionet që kishin tashmë programe të përgjithshme të rehabilitimit dhe riintegritimit, ato realizoheshin në bashkëpunim me punonjësit socialë dhe OSHC-të. Megjithatë, mungesa e përgjithshme e burimeve të përshtatshme financiare dhe personelit të trajnuar në këtë drejtim janë vërejtur si disa nga sfidat kryesore. Grupet përgjithësisht e kuptuan se kërkoheshin më shumë përpjekje për të rehabilituar të burgosurit dhe për t'i përgatitur ata për lirim.

Aty ku është e mundur, masat për rehabilitimin dhe riintegritimin në burg për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) përfshinin, ndër të tjera, mundësi për veprimtari të kalimit të kohës së lirë dhe trajnim profesional, punësim dhe këshillim psikologjik, pjesërisht me përfshirjen e përfaqësuesve të verifikuar të organizatave me bazë besimi (d.m.th., kryesisht imamët). Në disa raste, të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) u tha se kishin pak mundësi për sa i përket veprimtarive jashtë qelive, përveç punësimit të kufizuar. Disa pjesëmarrës shprehën shqetësimin për mungesën e programeve dhe trajnimeve të specializuara për të burgosurit e dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, të cilat u konsideruan si të rëndësishme për përgatitjen e këtyre të burgosurve për lirim. U theksua se pjesëmarrja e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) në programet e rehabilitimit dhe riintegritimit duhet të jetë vullnetare dhe të bazohet në pëlqimin e tyre të informuar.

Për më tepër, në diskutim u vu në dukje se të burgosurit e dhunshëm ekstremistë të dënuar ndonjëherë hezitonin ose refuzonin të përfshiheshin në ndërhyrje. Gjithashtu, ka pak stimuj materialë për të marrë pjesë në ndërhyrje të tilla. Për më tepër, frika për t'u indoktrinuar gjatë

ndërhyrjeve deradikalizuese, për përdorimin e informacionit kundër tyre nga inteligjenca dhe agjencitë e zbatimit të ligjit dhe për t'u perceptuar si informatorë në sytë e të burgosurve të tjerë, u përmendën si arsytet e kësaj mungese gatishmërie. Diskutimet theksuan gjithashtu shkeljet e mundshme të së drejtës së lirisë së fesë ose besimit dhe lirisë së mendimit dhe të shprehjes prej programeve të deradikalizimit. Ato vunë në dukje se disa ndërhyrje për të burgosurit (e dyshuar) për ekstremizëm të dhunshëm kanë vënë theksin te ndryshimi i besimeve (fetare), në vend të ndryshimit të sjelljes së dhunshme të të burgosurve, duke ngritur shqetësimet e lartpërmendura për të drejtat e njeriut të përshkruara gjithashtu në *Udhëzuesin e ODIHR-it/RPN-së për monitoruesit e burgjeve*.

Gjithashtu, shërbimet e provës u tha se ishin të pazhvilluara dhe të pashfrytëzuara në rajon dhe lirimi i hershëm i të burgosurve ekstremistë të dënuar për dhunë ishte i pazakontë. Në këtë drejtim u përmend një nismë e fundit e një organizate ndërkombëtare, e cila synonte të mbështeste shtetet e rajonit për të përmirësuar proceset e mbështetjes pas lirimit dhe për të forcuar rolin e shërbimeve të provës dhe agjencive të lidhura me to.

Gjatë diskutimit plenar pasues, u shprehën shqetësime edhe për praktikën e heqjes së shtetësisë të të burgosurve të dënuar për dhunë ekstremiste, veçanërisht LHT-ve të kthyer, e cila dukej se ishte rritur vitet e fundit. Pjesëmarrësit vunë re se strukturat kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile mund të luajnë një rol vendimtar për trajtimin e kësaj çështjeje duke nënvizuar pasojat e rënda të ligjeve, politikave dhe praktikave përkatëse mbi të drejtat e njeriut.

Sesioni 4: Mandatet, praktikat dhe qasjet ndaj monitorimit në burgje

Gjatë sesionit të katërt, disa monitorues ndërkombëtarë dhe kombëtarë të burgjeve ndanë përvojat dhe pikëpamjet e tyre në lidhje me mandatet, praktikat dhe qasjet e monitorimit të burgjeve. Perspektivat ndërkombëtare u ofruan nga përfaqësues të NPT-së të OKB-së, KPT-së¹² së Këshillit të Evropës dhe një MKP-je të Evropës Perëndimore, ndërsa përvojat kombëtare u ofruan nga përfaqësues të MKP-ve dhe OSHC-ve nga rajoni.

Për sa i përket rajonit të Evropës Juglindore, u vu në dukje se të gjitha shtetet kanë ratifikuar OPCAT-in dhe shumica kanë krijuar MKP funksionale.¹³ Në një shtet të përfaqësuar në aktivitet, institucioni i Avokatit të Popullit përdorte “modelin MKP-plus”, ku mandati ishte zgjeruar për të përfshirë organe të tjera, në veçanti OSHC të përzgjedhura dhe të akredituara, të cilat ishin ftuar të bashkëpunonin me Institucionin e Avokatit të Popullit për përmbushjen e mandatit të MKP-së.

Në lidhje me praktikat dhe qasjet specifike për monitorimin e trajtimit dhe kushteve të ndalimit të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar), gjatë seancës u ndanë përvoja të ndryshme. Disa MKP-të vërejtën se ose shumë pak ose aspak të burgosur ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) mbaheshin aktualisht në sistemet e tyre përkatëse të burgjeve, megjithëse të burgosur të tillë ishin burgosur më parë. Një përfaqësues tjetër i një MKP-je vuri në dukje se ata nuk kryen

¹² Përfaqësuesi i KiE-së e bëri prezantimin e tij online.

¹³ Pak përpara aktivitetit rajonal në shtator të vitit 2023, Parlamenti i Bosnje dhe Hercegovinës miratoi ligjin për të caktuar Avokatin e Popullit për të Drejtat e Njeriut si MKP të vendit. Vënia në jetë e mandatit mbetet hapi tjetër i rëndësishëm për t'u kryer për të pasur një MKP plotësisht funksionale.

ndonjë punë specifike në lidhje me të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) për shkak të mungesës së burimeve, por i përfshinin ata në metodologjinë e tyre si të burgosur të cenueshëm. Në disa shtete, MKP-të përkatëse kanë punuar vetëm në mënyrë reaguese, domethënë duke iu përgjigjur ankesave të paraqitura, ose kapaciteti i kufizuar institucional ka penguar aftësinë e tyre për të monitoruar trajtimin dhe kushtet e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm si një kategori specifike të burgosurish. Megjithatë, në një shtet, MKP-ja kishte realizuar një monitorim të përsëritur të një burgu të specializuar të sigurisë së lartë për personat e dënuar për krime të organizuara dhe vepra të lidhura me terrorizmin.

U pranua se, ndërsa MKP-të kishin mandate të forta në legjislacionin kombëtar për të monitoruar trajtimin e të burgosurve duke pasur parasysh bazën e tyre në OPCAT, qasja e monitoruesve të shoqërisë civile në burgje dhe informacion në kontekstet e burgjeve të sigurisë së lartë ishte më e kufizuar për shkak të kompetencave të tyre më të kufizuara. Përfaqësuesit e OSHC-ve raportuan se puna e tyre varej nga marrëveshjet individuale (p.sh. Memorandumet e Mirëkuptimit) me autoritetet e burgjeve, të cilat në përgjithësi nuk parashikonin vizita të paparalajmëruara, por mund të përfshinin qasje në dokumentacionin e dosjes së të burgosurve. U vu re gjithashtu se, në kontekstin e monitorimit të burgjeve, marrëdhëniet ndërmjet OSHC-ve dhe autoriteteve kombëtare vareshin dhe ndikoheshin nga aspektet e sigurisë dhe ndjeshmëritë politike. Për më tepër, monitorimi i burgjeve nga OSHC-të zakonisht kryhej bazuar në projekte specifike dhe për këtë arsye varej nga financimi i mjaftueshëm për zbatimin. Pavarësisht kësaj, aktivitetet monitoruese të OSHC-ve u konsideruan si një kontribut i rëndësishëm për përpjekjet e përgjithshme të lidhura me monitorimin e burgjeve.

Pavarësisht mandatit të veçantë, përfaqësuesit e MKP-ve dhe OSHC-ve nënvizuan rëndësinë e ndërtimit të besimit si me të burgosurit ashtu edhe me autoritetet e burgjeve për të kryer aktivitetet e monitorimit të burgjeve.

Nga këndvështrimi më i gjerë ndërkombëtar, u ndanë përvojat e NPT-së dhe KPT-së në lidhje me masat kundër terrorizmit që mund të ndikojnë negativisht mbi të drejtat e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar). Këto përfshinin, midis aspekteve të tjera, ndarjen e tyre nga të burgosurit e tjerë në burg dhe kufizimet përkatëse të të drejtave. Monitorimi i të burgosurve në mjediset e burgjeve të sigurisë së lartë ku mbaheshin të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) ishte thelbësor për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut, të tilla si izolimi i zgjatur, i cili mund të çojë në torturë dhe trajtime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese. Më tej u theksua se monitoruesit e burgjeve duhet të kenë parasysh rreziqet e mundshme të hakmarrjeve me të cilat mund të përballen të intervistuarit nga të burgosurit e tjerë dhe personeli i burgjeve kur flasin me ta. Kjo mund të përkeqësohet më tej në kontekstin e të burgosurve që janë etiketuar ose klasifikuar si “të radikalizuar” ose terroristë nga administrata e burgut ose gjykatat. Rëndësia e shmangies së stigmatizimit të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) në aktivitetet e tyre monitoruese u përsërit në prezantimin e MKP-së së Evropës Perëndimore. Sfida të tjera të lidhura me monitorimin, të cilat mund të identifikoheshin në shumë shtete në të gjithë rajonin e OSBE-së dhe më gjerë, përfshinin nevojën për të pasur qasje dhe për të monitoruar dosjet e klasifikuara dhe të inteligjencës për të burgosurit dhe për të kontaktuar me të burgosur që nuk janë në dijeni se ata klasifikohen si “të radikalizuar”.

Sesioni 5 – Sfidat dhe praktikat e mira lidhur me monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore

Sesioni i pestë ishte i dyti nga dy segmentet kryesore të grupeve ndëraktive të punës. Pas një përmbledhjeje të shkurtër të temës nga një folës prezantues, pjesëmarrësit u ndanë në grupe pune, të cilat u përqendruan te sfidat praktike me të cilat përballen monitoruesit e burgjeve në Evropën Juglindore dhe praktikatat e mira se si mund të trajtohen sfidat të tilla. Nga këto diskutime dolën disa tema kryesore.

Hyrja në objektet e burgjeve dhe intervistat konfidenciale të papenguara me të burgosurit dhe personelin

Sipas disa pjesëmarrësve, MKP-të në përgjithësi nuk janë hasur me pengesa sa i takon hyrjes në objektet e burgjeve (dhe të gjitha pjesët e tyre) ose në kryerjen e intervistave konfidenciale me të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) dhe me personelin. Megjithatë, pjesëmarrësit thanë se kufizimet e MKP-së për sa i përket burimeve njerëzore dhe financiare ndikojnë në fushën e aktiviteteve monitoruese të ndërmarra nga disa MKP në rajon. Një MKP deklaroi se ishte ankuar vazhdimisht për burimet e pamjaftueshme të vëna në dispozicion të saj në raportet e mëparshme vjetore. Gjithashtu u vërejt se shumë pak të burgosur refuzonin të flisnin me përfaqësuesit e MKP-së. Megjithatë, disa përfaqësues të MKP-së theksuan se ishte e nevojshme të krijohej besimi me të burgosurit dhe të krijohej perceptimi se MKP-ja vepronte në mënyrë të pavarur dhe transparente. Në këtë drejtim, u gjykua gjithashtu e nevojshme të menaxhoheshin pritshmëritë e të burgosurve në lidhje me çfarë mund të bënte një MKP për rrethanat personale të të burgosurve. Nuk pati asnjë përfaqësues të MKP-ve apo OSHC-ve që shprehu shqetësime specifike për hakmarrje ndaj të burgosurve si rezultat i aktiviteteve të tyre të monitorimit. Pavarësisht kësaj, disa pjesëmarrës sugjeruan që monitoruesit e burgjeve duhet të zhvillojnë politika formale për hakmarrjet. Gjithashtu, u tha se monitoruesit e burgjeve duhej të bënin kujdes në mënyrë që të mos veçonin të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) për të shmangur stigmatizimin e tyre të mundshëm nga të burgosurit e tjerë.

Qasja në informacionin me shkrim lidhur me privimin e lirisë si dhe disponueshmëria e informacionit të përgjithshëm

MKP-të raportuan pak probleme në lidhje me qasjen në informacion, ndërsa OSHC-të u shprehën se kishin shumë më pak qasje në informacionin me shkrim. Gjatë diskutimeve, asnjë MKP nuk raportoi se kishte hasur pengesa për të marrë informacion më të përgjithshëm, si p.sh. listat e burgjeve. Megjithatë, monitorimi i të ashtuquajturave informacione të “fshehta” ose të klasifikuara u përmend si proces i vështirë nga disa pjesëmarrës. Monitorues të shumtë të burgjeve, veçanërisht OSHC-të, raportuan se kishin pasur vështirësi për t’u njohur me përmbajtjen e dosjeve që kishin të bënin me klasifikimin dhe vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar). Një MKP vuri në dukje se, ndërsa në të kaluarën fillimisht i ishte mohuar qasja në informacionin e klasifikuar nga autoritetet e burgjeve, kjo çështje ishte zgjidhur pasi ajo i ishte referuar mandatit të saj si OPCAT të parashikuar në legjislacionin e brendshëm.

Niveli i bashkëpunimit me autoritetet dhe kuptimi i rëndësisë së monitorimit të pavarur të burgjeve

Disa përfaqësues të MKP-ve raportuan se bashkëpunimi me autoritetet e burgjeve në përgjithësi perceptohej si pozitiv. Nga ana tjetër, një përfaqësues i një MKP-je komentoi se bashkëpunimi me organet kombëtare të zbatimit të ligjit me raste ka qenë problematik. Në këtë drejtim u nënvizua rëndësia e ndërtimit të besimit me autoritetet me kalimin e kohës. Për më tepër, u vërejt se megjithëse të gjithë monitoruesit e burgjeve japin rekomandime të synuara, autoritetet e burgjeve jo gjithmonë i marrin ato mjaftueshëm parasysh. Në raste të caktuara, monitoruesit e burgjeve kishin dhënë të njëjtin rekomandim në mënyrë të përsëritur, ndërkohë që autoritetet e burgjeve nuk kishin marrë asnjë veprim lidhur me to. Burimet e kufizuara të MKP-ve për qëllimin e ndjekjes së rekomandimeve u përmendën si një sfidë shtesë.

Rolet e shoqërisë civile lidhur me monitorimin e burgjeve

Diskutimet në grup nxorën në pah se OSHC-të hynin në objektet e burgjeve zakonisht në bazë të marrëveshjeve të projekteve, të cilat ishin të kufizuara në kohë dhe përcaktonin llojin e hyrjes në ambientet e burgut, dhe të qasjes me të burgosurit dhe personelin, si dhe informacionin me shkrim. Në krahasim me MKP-të, mundësia e tyre për të hyrë në objektet e burgjeve ishte dukshëm më e kufizuar. Rrjedhimisht, vizitat e OSHC-ve në objektet e burgjeve ishte përgjithësisht të paralajmëruara. Pavarësisht sfidave specifike, përgjithësisht konsiderohej se OSHC-të kishin një rol thelbësor për të luajtur në lidhje me monitorimin e kushteve të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar), duke kontribuar për realizimin e përpjekjeve të MKP-ve dhe thirrjet e tyre ndaj autoriteteve të burgjeve për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve. Gjatë seancës, u ritheksua gjithashtu se MKP-të duhet të përfshijnë drejtpërdrejt OSHC-të në aktivitetet e tyre të monitorimit parandalues, siç është bërë në disa shtete të rajonit.

Raportimi publik dhe perceptimi i publikut lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndërsa luftohet terrorizmi dhe parandalohet EDHRÇT-ja

Pjesëmarrësit nuk përmendën asnjë kufizim specifik sa i takon raportimit publik. MKP-të në rajon u shprehën se ato botonin në mënyrë rutinë raporte të ndryshme publike (të tilla si raporte vjetore, tematike dhe të lidhura me vizitat) dhe se ato menaxhonin marrëdhëniet e tyre me median dhe publikun e gjerë. Përfaqësuesit e OSHC-ve përmendën se ishin po aq të lirë të publikonin gjetjet e aktiviteteve të tyre monitoruese.

Megjithatë, në një shtet, një përfaqësues i MKP-së deklaroi se vëmendja e institucionit të të drejtave të burgosurve ekstremistë të dhunshëm dhe publikimi i disa raporteve mbi burgjet e sigurisë së lartë kishte krijuar pak ndjeshmëri publike. Në disa shtete të tjera, thuhet gjithashtu se kishte pak keqardhje në lidhje me situatën e përgjithshme të të burgosurve të tillë, ose qëndrimet e publikut ishin madje edhe armiqësore. Kjo paraqiste sfida për MKP-të, të cilat ata duhej t'i merrnin parasysh në punën e tyre.

Sesioni 6: Rekomandime për forcimin e monitorimit të pavarur të burgjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore

Në sesionin e fundit u dhanë një sërë rekomandimesh që synojnë forcimin e monitorimit të pavarur të burgjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut duke parandaluar dhe luftuar EDHRÇT në burgje në Evropën Juglindore. Në veçanti, u rekomandua që çështja të trajtohej në mënyrë të gjithanshme, duke përfshirë të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë penale para, gjatë dhe pas burgimit dhe bazuar në një rishikim të kuadrit ligjor dhe të politikave kundër terrorizmit.¹⁴

Këto rekomandime janë integruar në listën e konsoliduar të rekomandimeve që dolën nga sesionet e ndryshme të aktivitetit, siç përcaktohet më poshtë. Pas seancës, aktiviteti rajonal u mbyll me përfundimet dhe komentet përfundimtare nga organizatorët.

III. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME KRYESORE

Për shtetet pjesëmarrëse në OSBE në Evropën Juglindore:

- Shtetet duhet të njohin rolin thelbësor që luajnë monitoruesit e pavarur të burgjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të burgosurve ndërsa parandalojnë dhe luftojnë EDHRÇT-në në burgje. Ato duhet të forcojnë kuadret kombëtare të të drejtave të njeriut për të promovuar monitorimin efektiv dhe të pavarur të parburgimit. Duke pranuar se të gjitha shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në Evropën Juglindore kanë ratifikuar OPCAT-in dhe kanë krijuar tashmë MKP-të e tyre, ato duhet të sigurojnë që këto organizma të jenë të pavarura, funksionale dhe të pajisura me burime të mjaftueshme për t'i lejuar ato të ushtrojnë plotësisht mandatet e tyre.
- Në veçanti, shtetet duhet t'u ofrojnë MKP-ve qasje në të gjithë informacionin me shkrim që i referohet trajtimit të personave të privuar nga liria, duke përfshirë të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar), dhe kushtet e tyre të ndalimit, duke përfshirë dokumentet e përcaktuara si të klasifikuara, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.¹⁵
- Shtetet duhet të njohin gjithashtu kontributin e rëndësishëm të shoqërisë civile në monitorimin e respektimit të të drejtave të njeriut nga shtetet në vendet e ndalimit. Shtetet duhet të krijojnë një mjedis që e lejon shoqërinë civile të veprojnë lirshëm dhe të lehtësojë

¹⁴ Për analizat e ODIHR-it mbi legjislacionin më të gjerë kundër terrorizmit dhe kontekstin e politikave, shih, për shembull, ODIHR, Shënim mbi Rishikimin e Propozuar të Përkufizimit të Veprave Terroriste në Nenin 1 të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit 2023, <https://legislationline.org/taxonomy/term/25663>, dhe Shënim mbi Konventën e Shangait për Luftën kundër Terrorizmit, Separatizmit dhe Ekstremizmit, 2020, https://legislationline.org/sites/default/files/documents/cf/382_TERR_BiH_21Sept2020_en.pdf. Të gjitha analizat ligjore të ODIHR-it mbi luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmin e dhunshëm mund t'i gjeni në: <https://legislationline.org/legal-reviews>.

¹⁵ Shih Nenin 20(b), Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Protokollin Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese, A/RES/57/199, 9 janar 2003, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/optional-protocol-convention-against-torture-and-other-cruel>.

punën e monitoruesve të pavarur të shoqërisë civile, duke përfshirë sigurimin e hyrjes në vendet e ndalimit dhe qasjen në informacion sipas nevojës.

- Shtetet duhet të sigurojnë që të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) të mos i nënshtrohen regjimeve të burgjeve dhe masave të sigurisë që shkelin standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht të mos i nënshtrohen izolimit të zgjatur. Ato gjithashtu duhet të përmbahen nga imponimi i regjimeve të burgjeve dhe masave të sigurisë që mund të rrezikojnë perspektivat e të burgosurve të tillë për rehabilitim dhe riintegrim të suksesshëm. Regjimet e burgjeve dhe masat e sigurisë që sjellin kufizime të të drejtave mund t'u vendosen të burgosurve vetëm në bazë të rezultateve të vlerësimeve objektive dhe në përputhje me të drejtat e njeriut, të cilat duhet të kryhen sa më shpejt të jetë e mundur në momentin e pranimit, të individualizohen dhe të rishikohen rregullisht dhe të përditësohen në një proces pjesëmarrës.
- Shtetet duhet të sigurojnë kushte të drejta dhe të përshtatshme punësimi për personelin e burgjeve për të përmbushur detyrat e tyre. Në veçanti në kontekstin e EDHRÇT-së, shtetet duhet të sigurojnë që pagat, statusi dhe kushtet e punës së personelit të burgjeve të pasqyrojnë natyrën e vështirë të detyrave të kryera prej tyre. Personeli i burgjeve duhet gjithashtu të trajnohet në mënyrë të përshtatshme për çështjet e lidhura me EDHRÇT-në, aty ku është e nevojshme, duke përfshirë sfidat e të drejtave të njeriut në lidhje me përdorimin e treguesve për të identifikuar të burgosurit “e cenueshëm” ndaj EDHRÇT-së, vlerësimet e rrezikut dhe nevojave, si dhe riintegrimin dhe rehabilitimin e të burgosurve.
- Duke qenë se shumica e të burgosurve të dënuar për vepra të dhunshme ekstremiste ose terroriste do të kthehen dikur në shoqëri, shtetet duhet të investojnë burime dukshëm më të mëdha për rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve të tillë dhe të sigurojnë që ndërhyrjet dhe aktivitetet e synuara të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut, të përshtatshme sipas gjinisë dhe moshës së tyre. Ata gjithashtu duhet të zhvillojnë dhe integrojnë programe të shkëputjes nga dhuna në programet para dhe pas lirit për të burgosur të tillë dhe duhet të analizojnë përfshirjen e aktorëve përkatës të shoqërisë për zbatimin e tyre.
- Shtetet duhet të krijojnë dhe/ose të zhvillojnë më tej kapacitetet e shërbimeve të tyre të provës për të burgosurit e dënuar për vepra që lidhen me terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Ata duhet të konsiderojnë zbatimin e skemave të lirit të parakohshëm për këta të burgosur, aty ku është e përshtatshme, dhe të sigurojnë që mbikëqyrjet administrative pas lirit të jenë plotësisht në përputhje me të drejtat e njeriut.
- Shtetet duhet të hartojnë, aty ku është e përshtatshme, masa që nuk kërkojnë mbajtjen në burg të “luftëtarëve të huaj terroristë” të kthyer dhe të ofrojnë mbështetjen e nevojshme rehabilituese dhe riintegruese për anëtarët e familjeve të tyre, veçanërisht gratë dhe fëmijët.
- Shtetet duhet të sigurojnë që legjislacioni i tyre kombëtar në lidhje me anti-terrorizmin të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe të drejtën ndërkombëtare për refugjatët. Për këtë qëllim, ato duhet të kërkojnë ndihmë nga ODIHR-i lidhur me çështjet

legjislative dhe të kërkojnë dhe të përdorin rishikimet e ODIHR-it për të analizuar përputhshmërinë e projektligjeve dhe ligjeve ekzistuese që lidhen me terrorizmin me të drejtat e njeriut, si dhe të strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për të parandaluar dhe luftuar EDHRÇT-në.¹⁶

Për organet e monitorimit të burgjeve dhe aktorët e shoqërisë civile në Evropën Juglindore:

- Gjatë realizimit të mandateve dhe aktiviteteve të tyre përkatëse, organet e monitorimit të burgjeve dhe aktorët e shoqërisë civile duhet të analizojnë me kujdes ndikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje mbi të drejtat e njeriut, duke përfshirë zbatimin e vlerësimeve të rrezikut, kufizimet e sigurisë dhe ofrimin e masave rehabilituese dhe riintegruese për të burgosurit.
- Monitoruesit e IKDNJ-ve, MKP-ve dhe OSHC-ve duhet të gjurmojnë dhe të dokumentojnë nga afër progresin e shteteve për zbatimin e rekomandimeve të tyre. Për këtë qëllim, atyre duhet t'u jepen burimet e nevojshme.
- Duke qenë se OSHC-të luajnë një rol të rëndësishëm monitorues në burgje në lidhje me trajtimin dhe kushtet e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar), MKP-të inkurajohen t'i përfshijnë ata në aktivitetet e tyre të monitorimit, nëse ende nuk e kanë bërë këtë gjë.
- Organet e monitorimit të paraburgimit dhe aktorët e shoqërisë civile duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të avokuar për forcimin e MKP-ve të pavarura, me burime të përshtatshme dhe funksionale në mënyrë efektive në rajon.
- Gjatë kryerjes së punës së tyre, organet e monitorimit të burgjeve dhe aktorët e shoqërisë civile duhet të jenë vigjilente për të siguruar që të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) të mos i nënshtrohen hakmarrjeve nga administrata e burgjeve ose të burgosur të tjerë. Në të njëjtën mënyrë, ata duhet të shmangin stigmatizimin e të burgosurve, duke përfshirë të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar), si rezultat i aktiviteteve të tyre monitoruese.
- Në veçanti, organet monitoruese të burgjeve duhet të mendojnë për hartimin dhe zbatimin e politikave të lidhura me hakmarrjet në kuadër të mandateve të tyre të vizitave në burgje. Për këtë, ata duhet të marrin parasysh rekomandimet përkatëse të organeve të traktatit të OKB-së, të tilla si NPT-ja e OKB-së.¹⁷
- Në përputhje me mandatet e tyre përkatëse, monitoruesit e IKDNJ-ve, MKP-ve dhe të OSHC-ve në rajon duhet të vlerësojnë dhe të paraqesin në mënyrë aktive propozime dhe vëzhgime në lidhje me legjislacionin, duke përfshirë ligjet kundër terrorizmit, si dhe

¹⁶ Për ndihmë legjislative nga ODIHR-i, shih <https://www.osce.org/odihr/407447>.

¹⁷ Për shembull, shih NPT-në e OKB-së, Politikat e Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese ose Ndëshkimeve për Hakmarrje në lidhje me mandatin e vizitës UN Doc. CAT/OP/6/Rev.1, 31 maj 2016, https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CAT/OP/6/Rev.1&Lang=en.

strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit për parandalimin e EDHRÇT-së, ku këto kanë ndikim mbi trajtimin dhe kushtet e personave të privuar nga liria.

Për ODIHR-in:

- ODIHR-i duhet të zhvillojë dhe forcojë materialet e trajnimit duke u bazuar te *Udhëzuesi i ODIHR/RPN-së për monitoruesit e burgjeve* dhe të organizojë aktivitete përkatëse trajnimi për monitoruesit e burgjeve. Aktivitetet duhet të përfshijnë trajnime rajonale për monitoruesit e burgjeve nga Evropa Juglindore për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit nga shtete të ndryshme të rajonit dhe më gjerë në lidhje me praktikën, metodologjitë dhe përvojat e monitorimit të burgjeve në lidhje me trajtimin e të burgosurve dhe kushtet e paraburgimit në kontekstin e parandalimit dhe luftimit të EDHRÇT-së.
- ODIHR-i duhet të vazhdojë të bashkëpunojë me organizata të tjera ndërkombëtare dhe mekanizma të të drejtave të njeriut për të mbështetur funksionimin efektiv të MKP-ve dhe IKDNJ-ve të pavarura në rajon.
- ODIHR-i duhet të mendojë për mundësinë e përkthimit të *Udhëzuesit të ODIHR-it/RPN-së për monitoruesit e burgjeve* në gjuhë të tjera për ta bërë atë më të aksesueshëm për palët e interesit në të gjithë rajonin e Evropës Juglindore.
- ODIHR-i duhet të vlerësojë mundësinë e zhvillimit të mjeteve praktike shtesë për monitoruesit e burgjeve duke u bazuar te *Udhëzuesi i ODIHR-it/RPN-së për monitoruesit e burgjeve*, si për shembull hartimin e këshillave dhe udhëzuesve të shpejtë të botuar në formate që mund të mbahen në xhep.

SHTOJCË: AGJENDA



Monitorimi i burgjeve dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ndërsa parandalojmë dhe luftojmë ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që çojnë në terrorizëm (EDHRÇT) në burgje

Aktivitet rajonal për Evropën Juglindore

13-14 shtator 2023

Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë

Agjenda

Dita 1	
9:00-9:30	Mbërritja dhe regjistrimi
9:30-9:45	Hapja dhe mirëseardhja
9:45-10:15	Sesioni 1: Përcaktimi i kontekstit – pse është i rëndësishëm monitorimi i pavarur i burgjeve për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje? Hyrje, qëllimi dhe objektivat e seminarit Prezantimi i Udhëzuesit të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reformës Penale Ndërkombëtare (RPN) për monitorimin e burgjeve dhe aktivitetet përkatëse <i>Moderator:</i> Përfaqësues i ODIHR-it <i>Folës:</i> Përfaqësues të RPN-së dhe ODIHR-it <i>Pyetje dhe përgjigje, komente dhe konstatime</i>
10:15-11:00	Sesioni 2: Praktika dhe qasje – parandalimi dhe luftimi i EDHRÇT-së në burgje <ul style="list-style-type: none">Vlerësimi i nismave dhe qasjeve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje <i>Moderator:</i> Përfaqësues i ODIHR-it <i>Folës:</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të Departamentit të Kërcënimeve Ndërkombëtare të Sekretariatit të OSBE-së, Njësisë për Veprim kundër Terrorizmit (TNTD/ATU), Zyrës së OKB-së për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe Rrjetit për Parandalimin e Dhunës
<i>11:00-11:20</i>	<i>Pushim për kafe</i>
11:20-12:45	<p>Sesioni 2: vazhdim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i nismave dhe qasjeve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje <p><i>Moderator: Përfaqësues i ODIHR-it</i></p> <p><i>Folës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Universitetit të Beogradit (Serbi), Shoqatës Maqedonase të Penologjisë (Maqedonia e Veriut) dhe Ministrisë së Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës. <p>Pyetje dhe përgjigje dhe debat i hapur</p>
<i>12:45-14:00</i>	<i>Pushimi i drekës</i>
14:00-15:00	<p>Sesioni 3: Sfidat kryesore të të drejtave të njeriut lidhur me parandalimin dhe luftimin e EDHRÇT-së në burgje në Evropën Juglindore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vështrim i përgjithshëm i sfidave kryesore të të drejtave të njeriut, përfshirë në lidhje me klasifikimin, rreziqet dhe vlerësimet e nevojave; regjimet e burgjeve dhe masat e sigurisë; si dhe masat rehabilituese dhe integruese për të burgosurit ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar). • Rrahje mendimesh lidhur me sfidat parimore të të drejtave të njeriut për parandalimin/luftimin e EDHRÇT-së në burgje në Evropën Juglindore (në grupe pune) <p><i>Moderator: Përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë</i></p> <p><i>Prezantues: Konsulent i ODIHR-it për monitorimin në burgje/kundërterrorizmin</i></p> <p><i>Pasuar nga diskutimi në grupe pune</i></p>
<i>15:00-15:20</i>	<i>Pushim për kafe</i>
15:20-16:20	<p>Sesioni 3: vazhdim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportimi i raportuesve të grupeve të punës në seancë plenare • Pyetje dhe përgjigje dhe debat i hapur <p><i>Moderator: Përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë</i></p>
16:20-16:50	<p>Sesioni 4: Mandatet, praktikat dhe qasjet ndaj monitorimit në burgje (pjesa 1)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim dhe vështrimi i përgjithshëm i mandateve ndërkombëtare dhe kombëtare të monitorimit të burgjeve, modeleve, praktikave dhe qasjeve të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore

	<p><i>Moderator: Përfaqësues i ODIHR-it</i></p> <p><i>Folës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të Nënkomitetit të OKB-së për Parandalimin e Torturës (NPT) dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) (prezantime online) <p><i>Prezantim mbi mandatet, praktikat dhe përvojat ndërkombëtare të monitorimit në vlerësimin e implikimeve të masave për të parandaluar dhe luftuar EDHRÇT-në në burgje mbi të drejtat e njeriut</i></p> <p>Pyetje dhe përgjigje</p>
16:50-17:00	Përfundimet e Ditës së 1-rë
nga ora 17:15	<i>Pritje e vogël për të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet</i>

Dita 2	
9:15-9:40	<p>Hyrje në Ditën e 2-të</p> <p><i>Moderator: Përfaqësues i ODIHR-it</i></p> <p><i>Folës: Përfaqësues i Këshillit të Evropës (prezantim online)</i></p> <p>Pyetje dhe përgjigje</p>
9:40-10:40	<p>Sesioni 4: Mandatet, praktikat dhe qasjet ndaj monitorimit në burgje (pjesa 2)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim dhe vështrim i përgjithshëm mbi mandatet ndërkombëtare dhe kombëtare të monitorimit të burgjeve, modeleve, praktikave dhe qasjeve të rëndësishme për Evropën Juglindore. Përvojat dhe mësimet e nxjerra gjatë monitorimit të kushteve në burgje, implikimet e vlerësimit të rrezikut dhe të nevojave të lidhura me EDHRÇT-në mbi të drejtat e njeriut, si dhe regjimet e burgjeve dhe masat e sigurisë të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (të dyshuar) <p><i>Moderator: Përfaqësues i ODIHR-it</i></p> <p><i>Ekspert ndërkombëtar për monitorimin e burgjeve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues i MKP-së franceze <p><i>Folës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të Avokatit të Popullit të Malit të Zi, Mbrojtësit të Qytetarëve dhe MKP-së së Serbisë dhe Avokatit të Popullit për Shpalljen e të Drejtave të Personave të privuar nga Liria të Bosnjë-Hercegovinës. <p>Pyetje dhe përgjigje dhe debat i hapur</p>
10:40-11:00	<i>Pushim për kafe</i>
11:00-11:45	Sesioni 4: vazhdim

	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim dhe përmbledhje e mandateve ndërkombëtare dhe kombëtare të monitorimit të burgjeve, modeleve, praktikave dhe qasjeve të rëndësishme për Evropën Juglindore <p><i>Moderator:</i> Përfaqësues i ODIHR-it</p> <p><i>Folës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfaqësues të organizatës joqeveritare Instituti për Aktivizëm dhe Ndryshime Sociale (Shqipëri) dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (Maqedonia e Veriut). <p><i>Pyetje dhe përgjigje dhe debat i hapur</i></p>
11:45-12:45	<p>Sesioni 5: Sfida dhe praktika të mira lidhur me monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbim përvojash dhe pikëpamjesh mbi sfidat praktike me të cilat përballen monitoruesit e burgjeve gjatë vlerësimit të implikimeve të praktikave dhe politikave për të parandaluar dhe luftuar EDHRÇT-në në burgje mbi të drejtat e njeriut, dhe si mund të trajtohen sfidat dhe praktikat e mira ekzistuese. <p><i>Moderator:</i> Përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë</p> <p><i>Prezantues:</i> Konsulent i ODIHR-it për monitorimin e burgjeve/kundërterrorizmin</p> <p><i>Pasuar nga diskutimi në grupet e punës</i></p>
<i>12:45-14:00</i>	<i>Pushimi i drekës</i>
14:00-15:15	<p>Sesioni 5: vazhdim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Raportimi i raportuesve të grupeve të punës në seancë plenare • Pyetje dhe përgjigje dhe debat i hapur <p><i>Moderator:</i> Përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë</p>
<i>15:15-15:45</i>	<i>Pushim për kafe</i>
15:45-16:30	<p>Sesioni 6: Rekomandime për forcimin e monitorimit të pavarur të burgjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ndërsa parandalohet dhe luftohet EDHRÇT-ja në burgje në Evropën Juglindore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Debat i hapur për identifikimin e rekomandimeve për shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, OSBE-në dhe aktorë të tjerë ndërkombëtarë, si dhe për monitoruesit e burgjeve dhe shoqërinë civile <p><i>Moderator:</i> Përfaqësues i ODIHR-it</p>
16:30-16:45	Përfundime dhe përmbyllja e aktivitetit